



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Republika e Kosovës / Opština Djakovica / Municipality of Gjakova
Arkiva Dalëse / Izlazne Archive / Output Archives
Nr. Invi/Br. Inv. 05-JJ31/1 - 27899
Data/Datum/Date 15.06.2026
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ne baze te nenit 8 paragrafi 3.2 te rregullores 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik te OJQ-ve shpalle kete:

THIRRJE PUBLIKE

Për dy përfaqësues nga grupi i Eksperteve të jashtëm, një nga OJQ dhe një Ekspert për komisionin vlerësues.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mireqenie Sociale, ka bërë hapjen e Thirrjes Publike për subvencionimin e OJQ ve në fushën e shëndetësisë të publikuar me datë 08.06.2026 me titull:

Thirrje publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve të licencuara në zbatimin e aktiviteteve të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale

DSHMS, fton të gjithë të interesuarit, të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues, si ekspert të jashtëm ose përfaqësues të OJQ-ve, që të aplikojnë të jenë pjesë e Komisionit.

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë këto kritere, të cilat ndikojnë në përzgjedhje si më poshtë:

1. Përvoja në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike (20 pike);
2. Përvoja në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbështetje financiare nga burimet publike (10 pike);
3. Njohja e dokumenteve strategjike dhe politikave me prioritet në fushën e thirrjes publike (15 pike);
4. Njohja e bazës ligjore në fuqi në fushat që mbulon thirrja publike (10 pike);
5. Njohja e metodologjive ekzistuese brenda fushës së thirrjes publike (20 pike);
6. Njohja e dokumenteve tjera relevante në fushën në të cilën është hapur thirrja publike (10 pike);
7. Njohja e gjuhës së institucioneve kryesore dhe qëllimit të tyre të punës në fushat në të cilat është hapur thirrja publike (15 pike).

Afati aplikimit: 15.06.2026 deri 19.06.2026

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë këto kritere:

Duhet të kenë diplome universitare;

Te kenë përvojë në hartimin e projekteve brenda fushës së thirrjes publike.

Dokumentet e kompletuara të dorëzohen në adresën: Rr; Bardhyl Qaushi p.n. 50000 Gjakove, Republika e Kosovës. /Zyra e DSHMS-se.

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIREQENIE SOCIALE

Postal address: Bardhyl Qaushi Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 (0) 390 320 050

<http://kk.rks-gov.net/gjakove/>